

## SHPALLJE PËR VENDE TË LIRA PUNE

Bazuar në Kreun V të Ligjit 33/2021 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Garda e Republikës shpall procedurat e aplikimit për:

- 2 vende të lira për punonjës në funksione të vaçanta, **specialist në sektorin e buxhet financës, në Gardën e Republikës.**

### I. KRITERET QË DUHET TË PLOTËSOJNË KANDIDATËT PËR PUNONJËS TË NIVELIT TË MESËM DHE BAZË:

- a) të jetë shtetas shqiptar;
- b) të mos jetë i përjashtuar nga institucionet e administratës shtetërore, të institucioneve ligjzbatuese dhe të mos jetë larguar nga shërbimi civil;
- c) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- ç) të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe i aftë për të kryer detyrën;
- d) të ketë përfunduar ciklin e dytë të arsimit të lartë përkatës;
- dh) të ketë përvojë pune jo më pak se 5 (pesë) vjet në fushën përkatëse;
- e) të mos jetë i dënuar me vendim gjykate të formës së prerë për kryerjen e një krimi ose për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje.

**Kandidati që nuk plotëson qoftë edhe një prej kriterëve të mësipërme, nuk kualifikohet dhe nuk mund të vazhdojë konkurrimin.**

### II. DOKUMENTET QË DUHET TË PARAQESIN KANDIDATËT:

Kandidatët që aplikojnë për punonjës në funksione të vaçanta, **specialist në sektorin e buxhet financës, në Gardën e Republikës**, duhet të paraqesin në fazën e parë të konkurimit dokumentet e mëposhtëm:

- a) Kërkesë
- b) CV (Kurikulum vitae)
- c) Kopje të kartës së identitetit
- d) Dëftesën e shkollës së mesme ose listë notash, të cikluar në Drejtorinë Arsimore të Rrethit, të fotokopjuar dhe të noterizuar dhe Diplomën e arsimit të lartë me listë notash, të fotokopjuar dhe të noterizuar.
- e) Vërtetim nga Gjykata.
- f) Vërtetim nga Prokuroria.
- g) Raport i aftësisë në punë (sipas shtojcës V, të VKM nr.596, datë 4.9.2019), nga mjeku i familjes.
- h) Dy foto (9 X 12) me kostum dhe kollare.
- i) Vërtetim ose librezë pune që vërteton përvojën e punës në fushën përkatëse.

Dokumentet dorëzohen në adresën: “Garda e Republikës, Rruga e Elbasanit, pranë Pallatit të Brigadave, Tiranë, me postë ose duke u paraqitur personalisht në ambientet e Gardës.

Afati përfundimtar për dorëzimin e dokumenteve është **brenda datës 22.05.2026.**

### III. SHQYRTIMI I DOKUMENTACIONIT DHE PROCESI I ANKIMIMIT

Afati i shqyrtimit dhe verifikimit të dokumentacionit është 1 ditë pune nga përfundimi i afatit të aplikimit. Kandidati që nuk plotëson kriteret dhe nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar brenda afatit të aplikimit, skualifikohet dhe do të njoftohet individualisht për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail ose me telefon).

Kandidati ka të drejtën e ankimit brenda 2 ditëve nga data e njoftimit të përgjigjes. Komisioni i Apelit shqyrton ankesat dhe kthen përgjigje brenda 2 ditëve nga data e marrjes së ankesës.

### IV. TESTIMI I KANDIDATËVE

Kandidatët e kualifikuar në fazën e dorëzimit dhe kontrollit të dokumenteve, duhet të paraqiten **në orën 08:00 të datës 26.05.2026**, në adresën: Garda e Republikës, Rruga e Elbasanit, pranë Pallatit të Brigadave, Tiranë, për t'iu nënshtruar testimit me shkrim dhe intervistës. Kandidati që nuk paraqitet për testim, skualifikohet.

### V. MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Për vlerësimin e kandidatëve përdoret sistemi me 100 pikë, i cili përbëhet nga këta komponentë:

- Testimi me shkrim 70 pikë
- Intervista 30 pikë

Aplikanti skualifikohet kur nuk arrin të marrë të paktën 40 pikë të testimit me shkrim. Renditja e kandidatëve do të bëhet sipas rendit zbritës të pikëve, nga rezultati më i lartë në atë më të ulët.

### VI. KOMUNIKIMI I REZULTATEVE TË KONKURRIMIT

Në përfundim të të gjithë procedurës së konkurrimit dhe vlerësimit të kandidatëve, të gjithë kandidatët fitues, do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike (e-mail personal) ose me telefon nga Garda e Republikës.